



Zgjedhjet konkurruese ndjekin bashkëpunimin ndërpartiak për t'i dhënë fund krizës politike, megjithëse nevojat për reforma të qëndrueshme mbeten, thonë vëzhguesit ndërkombëtarë të zgjedhjeve në Shkup

SHKUP, 12 dhjetor 2016 – Zgjedhjet parlamentare të 11 dhjetorit në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë ishin konkurruese dhe një hap thelbësor në zgjedhjen e krizës së thellë politike dyvjeçare, por u zhvilluan në një mjedis të karakterizuar me mosbesim të përhapur publik në institucionet dhe sistemin politik, përfunduan vëzhguesit ndërkombëtarë të zgjedhjeve në një deklaratë paraprake të lëshuar sot.

Përderisa fuqitë kryesore politike ranë dakord për një seri të ndryshimeve ligjore dhe institucionale për të siguruar një fushë loje të niveluar, çështjet themelore të tilla si në lidhje me mediat dhe regjistrimin e votuesve duhet ende të trajtohen në mënyrë të qëndrueshme, thotë deklarata.

"Dalja e lartë dëshmon se votuesit e kuptuan rolin vendimtar që e ndërmarrin zgjedhjet e mira për të ardhmen e vendit të tyre", tha Roberto Battelli, Koordinatori Special dhe kryesuesi i misionit vëzhgues afatshkurtër të OSBE-së. "Establishmenti politik tani ka përgjegjësi për t'i plotësuar këto pritje. Ata duhet të shfrytëzojnë këtë moment dhe mandatin që iu është dhënë për të vazhduar me reformat e nevojshme për ardhmërinë e vendit."

Përmirësimet e rëndësishme në legjislacionin zgjedhor trajtuan shumicën e rekomandimeve të mëparshme nga ODIHR dhe Komisioni i Venedikut i Këshillit të Evropës dhe paraqitën mekanizma të përkohshme për mbikëqyrjen ndërpartiake të aspekteve kryesore të procesit zgjedhor. Megjithatë, thotë deklarata, se disa rekomandime mbeten të patrajtuara dhe ca dispozita janë të paqarta.

"Vendi është në një udhëkryq të ri, i cili hap një rrugë drejt normalitetit në jetën politike. Të gjitha palët tani duhet të dëshmojnë angazhimin e tyre për të drejtuar vendin në këtë rrugë", tha Stefan Schennach, Shefi i delegacionit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës. "Komunitetet e ndryshme etnike tanimë dhanë provë, gjatë protestave verës së kaluar, se bashkëpunimi drejt një qëllimit të përbashkët politik është i mundur. Tani, tërë vendi duhet të zëvendësojë ndarjen etnike me bashkëpunim për ndërtim të kombit."

Përderisa liritë themelore u respektuan në përgjithësi dhe garuesit ishin në gjendje të bënin fushatë të lirë, pat akuza për frikësimin e votuesve dhe presion të gjerë mbi punëtorët publik, të verifikuara nga vëzhguesit në një duzinë të rasteve.

"Ne pamë një numër të madhë të njerëzve të cilët dëshironin për më mirë për vendin e tyre dhe për gjeneratat që do të vijnë. Trendet pozitive që i vëzhguam, tashmë duhet të rikrijohen në mekanizma të qëndrueshme, kurse mangësitë që i listuam do të duhet të trajtohen përmes dialogut të mirëfilltë brenda institucioneve relevante shtetërore, por edhe në parlament respektivisht," tha Azay Guliyev, Shefi i delegacionit të Asamblesë Parlamentare të OSBE-së. "Të gjitha forcat politike duhet të punojnë për të siguruar se nuk do të ndodhë kthim mbrapa në krizë politike."

Përgatitjet e Komisionit Shtetëror Zgjedhor (KSHZ) për zgjedhje ishin të penguar nga organizimi joefikas i brendshëm, vendimmarrja e politizuar dhe afateve të shkurtuara ligjore, thane vëzhguesit. Aktivitetet e Komisionit nuk ishin gjithmonë transparente, pasi që shpeshherë mbante seanca të mbyllura dhe jo gjithmonë publikonte vendimet e saja.

Dita e zgjedhjeve u administrua mire në përgjithësi dhe u zhvillua pa incidente të mëdha.

"Ne besojmë se këto zgjedhje kanë treguar se populli në këtë vendi don, dhe plotësisht meriton, të shoh përfundimin e periudhës së gjatë të krizës politike. Ne presim të shohim një sinjal të qartë nga qeveria e re që do të punojë me të gjitha partitë politike në parlament për t'i kryer urgjentisht reformat e nevojshme", tha Igor Sholtes, Shefi i delegacionit të Parlamentit Evropian. "U bëjmë thirrje të gjitha palëve që të sigurojnë mbështetjen e nevojshme për institucionet e drejtësisë, dhe Zyres së Prokurorit Special në veçanti, pasi që puna e saj duhet të kryhet në tërësi."

Mjedisi i shumëllojshëm mediatik është i ndarë përgjatë linjave politike dhe etnike dhe monitorimi tregoi se, megjithëse mediat publike kryesisht ju ofruan garuesve mbulim të barabartë në lajme, disa media private demonstuan njëanshmëri në favor të partisë në pushtet. Reformat e rëndësishme të parapara për mediat kanë ende për t'u zbatuar.

"Ngjarjet që drejtuan në këto zgjedhje kërkonin bashkëpunim ndërpartiak për të gjetur mekanizma të përkohshme për trajtim të çështjeve tejet të rëndësishme. Si rezultat, procesi u përmirësua, veçanërisht përsa i përket mediave dhe kornizës ligjore", tha Tana de Zulueta, Shefe e misionit të vëzhgimit të zgjedhjeve të ODIHR-it. "Për këto përmirësime të jenë të qëndrueshme, do të jetë e domosdoshme që të adresohen mangësitë themelore. Kjo do të kërkojë bashkëpunimin e mëtejshëm dhe angazhimin për reforma sistematike dhe, që është edhe më me rëndësi, përpjekje gjithëpërfshirëse për reforma zgjedhore."

Teksti i plotë i deklaratës është në dispozicion në: <http://www.osce.org/odihr/elections/fyrom/288186>

Për informata të mëtejshme, kontaktoni:

Thomas Rymer, OSBE/ODIHR, +995 595 126 333 or +48 609 522 266, thomas.rymer@odihr.pl

Iryna Sabashuk, OSCE AP, +389 71 465 079 or +45 60 10 81 73, iryna@oscepa.dk

Bogdan Torcatoriu, AKPE, +389 70 985 839 or +33 6 39 29 40, bogdan.torcatoriu@coe.int

Gerrard Quille, PE, +38971465084 or +32473525072, gerrard.quille@ep.europa.eu